



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:267603

Datë: 29.06.2020

Numri i dokumentit: 00993874

A.1003/15

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Vjollca Limani, procesmbajtësen/zyrtaren ligjore Gzona Rama Demaj, në konfliktin administrativ të paditësit S.J., nga fshati B., Komuna e Gjakovës, kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), për shkak të anulimit të aktvendimit, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me dt.18.06.2020, në prani të të dyja palëve, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S.J., me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të anulohet aktvendimin e të paditurës AKK nr.03/593/15 të datës 30.04.2015, aktvendimin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjakovës 07 nr.466-2771/13 të datës 19.07.2013 dhe lënda ti kthehet organit të shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

II Secila palë i bartë shpenzimet e veta administrative.

A r s y e t i m

Sipas padisë së paditësit, të parashtruar me dt.03.06.2015, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor në këtë çështje juridike, e cila është mbajtur me dt.03.06.2015, në praninë e të dyja palëve.

Kështu paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor qëndroi në tërësi si në padi dhe kërkespadi, ndërsa nëpërmes padisë ka atakuar aktvendimin e të paditurës me nr.03/593/15 të datës 30.04.2015, duke theksuar se, konstatimi dhe vlerësimi i organit të shkallës së parë e po ashtu organit të shkallës së dytë nuk ka mbështetje në asnjë provë materiale. Konstatimi i organit të shkallës së parë se ngastrat kadastrale janë pronë dhe evidentohen si pasuri shoqërore e Komunës së Gjakovës, mendoi dhe vlerësoi se nuk qëndron pasiqë në posedim të kësaj palujatshmërie jam në bazë të punës juridike të vlefshme-Kontratës mbi qesim të lidhur me Ekonomin Pyjore Gjakovë. Varësisht nga ndryshimi eventual statusor i këtij subjekti juridik apo të statusit të kësaj palujatshmërie unë do të vazhdojë po qëse më mundësohet që të vazhdoi me kontratën mbi qesim apo të përpiloi kontratë të re mbi qesimin. Prandaj unë uzurpues nuk jam dhe as që si i tillë mund të trajtohem. Si aktvendimi i shkallës së parë ashtu edhe aktvendimi i atakuar në vete nuk përmbajnë as edhe një arsytim mbi faktet relevante ashtu që në vete përmban kundërthënie e posaqërisht kundërthënie në mes të arsyeve të dhëna dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës e që në masë të madhe ka ndikuar në nxjerrjen e një përfundimi të gabuar dhe tërësisht në dëm të paditësit. Me aktvendimin e atakuar që në startë vërehen këto të lëshime dhe të meta e që me vërtetimin e gabuar dhe jo të mjaftuar të gjendjes faktike ka ardhur deri te aplikimi i gabuar i së drejtës materiale në dëm të paditësit. Shton se në palujatshmërinë pretenduese paditësi me kontributin e tij dhe të familjarëve ka ndërtuar një objekt rekreativ sezonal tani e shumë vite më parë dhe ky objekt ka vlerë

shumëfish më të madhe se sa vetë palujatshmëria. Padiësi dhe familjaret e tij nuk mundën me qenë viktim e heshtjes së organit të administratës komunale gjatë dhe në kohën e ndërtimit dhe të posedimit të pandërprerë mbi 19 viti (kjo periudh është llogaritur deri në parashtrimi e padisë 03.06.2015). Mbi këto arsye i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të aprovoi padinë e tij dhe të anuloi aktvendimin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjakovës 07 nr.466-2771/13 të dt.19.07.2013 si dhe aktvendimin e AKK me nr.ref.03/593/15 të dt.03.04.2016 dhe lënda ti kthehet organit të shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

E paditura në seancën e shqyrtimit kryesor është përfaqësuar nga N.Sh., i cili qëndroi në tërësi si në përgjigjen në padi të dorëzuar kësaj gjykate me datë 05.08.2016. Ndërsa përmes saj e paditura ka kërkuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesëpadija e padiësit për anulimin e aktvendimit të të paditurës dhe të vërtetohet aktvendimi me nr. 03/593/15 i datës 30.04.2015 i AKK. Ka thesuar se padiësi në ankesën e parashtruar para këtij organi përvec thënieve ankimore me anë të të cilave e atakon aktvendimin 07 nr.466-2771/13 të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit KK Gjakovë në AKK nuk ka ofruar asnjë provë materiale me të cilat do të bazojë pretendimin e tij dhe do të rezultonte ndëonjë vendim tjetër nga ai i DUMM- KK Gjakovë.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor, të mbajtur me dt.18.06.2020, pas dëgjimit të palëve ka bërë administrimin e provave dhe atë është administruar: Vendimi i AKK me nr 03/593/15 i dt.30.04.2015; dokumenti me lëndën “Plotësimi i lëndës sipas kërkesës me nr.ref. 03/593/15 e dt.28.04.2015; dokumenti me subjektin “Plotësimi i lëndës” i dt.17.04.2015; Aktvendimi i lëshuar nga KK Gjakovë me nr.07.Nr.466-2771/13 i dt.19.07.2013; Aktvendimi i lëshuar nga KK Gjakovë 07 Nr.466-4473/15 i dt.10.02.2015; Konkluzioni mbi lejminin e ekzekutimit i lëshuar nga KK Gjakovë; Historiati me nr.952-06/15, i lëshuar me datë 08.01.2015 dhe datë 05.01.2015; dokumenti me subjektin “Përcjellja e lëndëve–uzurpimi arbitrar i tokës në pronësi shoqërore e dt.14.02.2013, për lëndën me nr.11-466-6120; Konkluzioni i lëshuar nga KK Gjakovë 11 Nr.466-6120 me dt.26.11.2014; Konkluzioni i lëshuar nga KK Gjakovë 11. Nr.466-6129 me datë 26.11.2004; Konkluzioni 11 Nr.466-6130, 11 Nr.466-6123, 11 Nr.466-6125, 11 Nr.466-6122 të gjitha të lëshuara me datë 26.11.2014; Konkluzioni i lëshuar nga KK Gjakovë 07 Nr.466-2771/13 i datës 27.05.2013; Konkluzioni i lëshuar nga KK Gjakovë 07-466-2864 i dt.27.05.2013; Konkluzion 07.Nr.466-2771/13 i dt.30.05.2013; dokumenti me subjektin “Sipas detyrës Zyrtare- vërtetimi i uzurpimit arbitrar të tokës në pronësi shoqërore-lajmërim thirrje për palën”; Procesverbali 07 Nr.466-2771/13 i përpiluar me dt.19.06.2013; dokumenti me lëndën “Sipas detyrës zyrtare- uzurpim arbitrar i tokës në pronësi shoqërore- historiati kadastral” i dt.11.07.2013; Fletposedimi i lëshuar me dt.11.07.2013; Dëshmi e fletëdorëzimit lidhur me shkresën 07 Nr.466-2771/13; Dëshmi lidhur me dorëzimin e shkresës, e datës 25.07.2013; Konkluzioni 07 Nr.466-2771/13 i dt.21.04.2015; Kontrata e dt.30.05.1996; Historiati me nr.16-39/13; Vendimi me nr.01-011-4 i dt.30.01.1998; dokumenti me lëndën “ Përcjellja e lëndëve-uzurpimi arbitrar i tokës në pronësi shoqërore” lidhur me lëndën 11-466-6125, 6130, 6122, 6129, të gjitha të lëshuara me datë 14.02.2013; dokumenti me emërtimin “Ekspertizë” lidhur me parcelat 1066, 1067, 1068, 1069, 1070, 1071 dhe 1245; ankesa me nr prot 03/593/15 e dt.08.04.2015; Dëshmia e pagesës e dt.03.06.1996 dhe dokumenti me emërtimin “ Thirrje për palën”.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara, ku ka gjetur se kërkesëpadija e padiësit është e pabazuar.

Me aktvendimin e Komunës së Gjakovës Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUMM) me 07 nr.466-2771/13 të datës 19.07.2013, thuhet se, është vërtetuar se padiësi S.J., nga fshati B., Komuna e Gjakovës është uzurpues i tokës në pronësi shoqërore, përkatësisht pjesëve të saja, -të Komunës së Gjakovës që sipas Certifikatës mbi të drejtën e pronës së paluajtshme UL-70705008-00561 ZK B., evidentohen si: ngastrat kadastrale nr.1066 në sipërfaqe prej 0.18.00 ha, ngastra kadastrale nr.1067 në sipërfaqe prej 0.30.00 ha, ngastra kadastrale nr.1069 në sipërfaqe prej 0.34.23 ha, ngastra kadastrale nr.1070 në sipërfaqe prej 0.59.16 ha, ngastra kadastrale nr.1071 në sipërfaqe prej 0.51.05 ha, -të rrugëve publike, që sipas Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UI-70705008-00598 Xk B., evidentohet si ngastra nr.1068, në sipërfaqe prej 0.03.30 ha, dhe-të ujrave publike që sipas

Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-70705008-00599 ZK B., evidentohet si 1245 në sipërfaqe prej 0.47.86 ha. Me të njëjtin vendim është detyruar uzurpuesi që të lëshoj tokën e uzurpuar pas plotëfuqishmërisë së tij.

Ndërsa me aktvendimin e kontestuar të të paditurës 03/593/15 të datës 30.04.2015 ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit e parshtruar kundër vendimit të DUMM, si më lartë.

I pakënaqur me këtë aktvendim paditësi ka parashtruar padi, dhe për vlerësuar ligjshmërinë e tij Gjykata, i'u referua: **LIGJIT MBI SHQYRTMIN E MARDHËNIEVE PASURORE TË KRIJUARA ME UZURPIMIN ARBITRAR TË TOKËS NË PRONËSI SHOQËRORE** (Gazeta zyrtare e KSAK nr.46/77, ligj ky i zbatueshmë sipas nenit 1 të Rregullorës për ligjin në fuqi në Kosovë (rregullorja e UNMIK nr.1999/24)), dhe atë nenit 16, i cili në paragrafi 1 dhe 2 ka përcaktuar:

16.1 Në qoftë se gjatë procedurës vërtetohet se uzurpimi arbitrar i tokës në pronësinë shoqërore është bërë pas 14 hkurtit 1960 organi i administratës do të marr akvendimin me të cilin do të caktojë se uzurpuesi arbitrar ka për detyrë ta lëshoj tokën e uzurpuar arbitrarisht dhe të menjanojë objektet nëse janë ndërtuar në atë tokë.

16.2 Afati për lëshimin e tokës dhe për menjanimin e objekteve në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë as më i gjatë se tre muaj, duke llogaritur prej hyrjes në fuqi të aktvendimit.

Më pas gjykata iu referua dhe mori për bazë edhe provat relevante të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe atë nëpërmes Kontratës mbi qiramarrjen e tokës pyjore, me nr.01-7308/1 të datës 31.05.1996, konstatoi se ish Ekonomia e Pyjeve Pejë i kishte dhënë paditësit në shfrytëzimin me qira ngastrën nr.545, në sipërfaqe pre 1.11.51 ha, për kultivim dhe kullasje dhe atë për peridhën nga data 30.05.1996 deri me 31.12.1996, ndërsa në emër të qiras paditësi ishte detyruar të pagauj shumën prej 334,50 dinar, e të cilën shumë në bazë të dëshmisë urdhërpagesës së datës 03.06.1996 paditësi vecse e kishte ekzekutuar.

Në bazë të Historiatit të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Gjakovë, me datë 05.01.2015 dhe 08.01.2015, bëhet e qartë se parcela nr.545 sipas shënimeve të vitit 1983-1988 ishte e evidentuar në posedim të PSH “Kombinati Industrial Pyjore, Pejë” dhe prej kësaj parcele ishin formuar parcela të reja dhe atë: parcela nr.1070 në sipërfaqe prej 0.59.16, parcela nr.1071 në sipërfaqe prej 0.51.05 ha, sipas fletëposedimit me nr.522 dhe janë evidentuar në posedim të PSH.Bashkësia Lokale, B.. Të njëjtat parcela, bazuar në vendim nr.01-011-4 të datës 30.01.1998, kanë kaluar në posedim të Kuvendit të Komunës së Gjakovës . Po ashtu formohen parcelat nr.1066 në sipërfaqe prej 0.30.03 ha, nr.1067 në sipërfaqe prej 0.32.03 ha, nr.1069 në sipërfaqe 0.34.23 ha, sipas fletëposedimit nr.561 dhe evidentohen në posedim të PSH. Kuvendi i Komunës, Gjakovë, pastaj parcela nr.1068 në sipërfaqe prej 0.09.41 ha, sipas fletëposedimit nr.598 dhe evidentohet në posedim të PSH Rrugë publike si dhe parcela nr.1245 në sipërfaqe 4.15.04 ha, sipas fletëposedimit nr.599 që evidentohet në posedim të PSh Ujra publike.

Nga këto prova konstatohet se paditësi shfrytëzim e parcelës 545 në bazë të punës juridike/kontratës kishte mundësi ta bënte vetëm për periudhën 30.05.1996- 31.12.1996, ndërsa pas kësaj periudhe e kishte në posedim dhe shfrytëzim pa kurrfarë baze juridike paluajtshërinë në ngastrat dhe sipërfaqet si të konstatuar dhe përcaktuara me ekspertizën e daljes në vend shiqim të datës 09.06.2004 dhe me vendimin e organit të shkallës së parë.

Paditësi bazuar në procesverbalin 07 nr.466-2771/13, të përpiluar në DUMM me dt.19.06.2013, vetë kishte deklaruar se ka kufizuar me tel gjëmbor dhe hunjë druri ngastrat nr. 1066, 1067, 1068 përkatësisht pjesë të tyre, në ngastrën nr.1245 ka ndërtuar pishin dhe objekte të tjera ndihmëse, ndërsa ngastrat nr.1069, 1070, 1071 dhe një pjesë e ngastrës 1245 po ashtu i kishte rrethuar me telë gjëmbor dhe i shfrytëzon për bujqësi dhe kullosë të bagëtisë.

Nga e gjithë kjo gjendje e konstatuar rezulton se paditësi ka kryer uzurpimin arbitrar të tokës në pronësi shoqërore, prandaj me të drejtë organi i shkallës së parë dhe organi i shkallës së dytë bazuar në dispozitat e nenit 16 të Ligjit mbi shqyrtimin e mardhënieve pasurore të krijuara me uzurpimin arbitrar të tokës në pronësi shoqërore, paditësin e shpall uzurpues të paluajtshmërisë të përmendur si më lartë dhe e detyron të lëshojë tokën e uzurpuar.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e paditësit të dhëna në padi dhe në seancë kryesore dhe të njëjtat i refuzoi si të pabazuara, të paargumentuara dhe pa ndikim në konstatim e një gjendje tjetër faktike.

Prandaj, si përfundim gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, nga i padituri drejtë është vërtetuar gjendja faktike, drejtë janë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe të ligjit material, kur është vendosur si në vendimin lidhur me të cilin është hapur konflikti.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur konform nenit 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartë cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.1003/15, dt.18.06.2020

Zyrtarja Ligjore
Gzona Rama Demaj

G j y q t a r j a
Vjollca Limani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh ngadita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.